

dialoguqeveridonatorë

Buletin Informativ – Verë 2011, Botimi nr. 52

Përpjekje e përbashkët e Departamentit të Bashkëndimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj dhe Sekretariatit Teknik të Donatorëve

www.dsdc.gov.al

www.aidharmonisation.org.al

Ministri i Financave, Ridvan Bode dhe Ambasadori Italian në Tiranë, Saba D'Elia nënshkruan më 24 gusht 2011 marrëveshjen e konvertimit të borxhit me vlerë totale 20 milion euro. Marrëveshja është pjesë e paketës së asistencës financiare të parashikuar nga Protokolli i Bashkëpunimit për Zhvillim 2010-2012 ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë.

Marrëveshja parashikon konvertimin e borxhit të Shqipërisë ndaj Italisë në burime financiare për zbatimin e projekteve të zhvillimit shoqëror. Si realizohet ky konvertim? Këstet e borxhit që Qeveria shqiptare duhet t'i paguante Qeverisë italiane për shlyerjen e huave të buta të marra më parë, do të derdhen në një llogari të posaçme pranë Bankës së Shqipërisë (fond homolog). Ministria e Financave do të derdhë në këtë fond aq këste sa të plotësohet shuma prej 20 milion eurosh. Në sajë të këtij mekanizmi, Komiteti i Menaxhimit të fondit homolog i ngritur nga kjo Marrëveshje, do të disponojë burimet e nevojshme financiare për të financuar projekte në fushën e hapjes së vendeve të punës, arsimit, shëndetësisë dhe më në përgjithësi, të përfshirjes sociale të shtresave në nevojë.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes duhet të hartohet një manual operacional me udhëzime për përgatitjen e projekteve që do t'i dorëzohen Komitetit të Menaxhimit. Përfaqësues të Qeverisë shqiptare dhe ekspertë të Koperacionit Italian për Zhvillim do të merren me vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekteve nga kjo skemë borxhi për zhvillim, si edhe do të monitorojnë dhe do të vlerësojnë zbatimin e aktiviteteve dhe arritjet.

■ Foto: Ministri i Financave, Ridvan Bode; Ambasadori italian në Tiranë, Saba D'Elia; Drejtori i Kooperacionit Italian për Zhvillim, Aldo Sicignano; Programme Officer i Kooperacionit Italian në Shqipëri, Valerio Cendali Pignatelli



Nënshkruhet Marrëveshja e Konvertimit të Borxhit ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë me Ministrin e Financave, Ridvan Bode

Në këtë numër

- Nënshkruhet Marrëveshja e Konvertimit të Borxhit ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë
- Intervistë me Daniel Züst, Drejtor i Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri
- Qeveria zvicerane akordon fonde shtesë për forcimin e Pushtetit Vendor
- Emërohet drejtoresha e re e Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri
- Vizitë në Shqipëri e Ministrit Federal gjerman, Dirk Niebel
- BE dhe OSBE ndihmojnë autoritetet shqiptare me regjistrimin e zonave bregdetare prioritare
- Realizimi i Reformës së Administratës Publike në Shqipëri - Hapat kyç për Integrimin Evropian
- UNODC mbështet përpjekjet e Shqipërisë kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
- Përfaqësia e Francës në Zyrën e OKB në Vjenë financon për hapjen e një salle këshillimi për viktimat e trafikut.
- Kooperacioni Italian për Zhvillim investon për didaktikën dhe kërkimin shkencor universitar
- Projekti "Mbështetje dhe Zgjerim i Sistemit të Thesarit në Shqipëri - SETS" mbështet luftën kundër pastrimit të parave në Shqipëri
- Lançohet Raporti i Investimeve Botërore 2011
- Përurohen pikat e kalimit kufitar dhe stacionet e Kufirit të Gjellbër
- Prezenca e OSBE-së diplomon nëpunësit ministrorë që merren me barazinë gjinore
- Seminar për hetimin e aseteve kriminale
- Projekti i UNODC mbështet Trajnimin e punonjësve të kufirit për Vlerësimin e Riskut
- Prezenca e OSBE-së mbështet Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Policinë e Shtetit për administrimin e zgjedhjeve të pjesshme
- Vizitë studimore në Indonezi e përfaqësuesve të Qeverisë dhe OJF-ve
- Gjermania jep 2 milion euro për menaxhimin e mbetjeve urbane
- Programi Kërkimor në Shkencat Sociale, i financuar nga Zvicra
- Manuali "Menaxhimi me Bazë Rezultatesh" për njësitë e qeverisjes vendore
- Ministria e Punës, strategji për punësimin e 65 mijë të rinjve



Intervistë me Daniel Züst, Drejtor i Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri

Daniel Züst erdhi në Shqipëri para katër vitesh kohë gjatë të cilës ka shërbyer si Drejtor i Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri. Para se të nisej për detyrën e radhës si Shef i Bashkëpunimit për Zhvillim në Ambasadën zvicerane në Mozambik, patëm kënaqësinë t'i marrim një intervistë.

Si do ta përshkruanit punën tuaj 4-vjeçare si Drejtor i Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri? Ju ka pëlqyer?

Sigurisht që më ka pëlqyer qëndrimi në Shqipëri në përgjithësi, veçanërisht sepse ekziston njëfarë kontrasti mes reputacionit "të jashtëm" të Shqipërisë dhe realitetin që gjën kur punon këtu. Ndonjëherë ka qenë edhe sfidë e vështirë për shkak të ngarkesës së madhe të punës ku dua të përmend disa gjëra kryesore: fill pas ardhjes sime, Bashkëpunimi Zviceran filloi me punën intensive për zhvillim, bazuar në Strategjinë për Bashkëpunim të periudhës 2006-2009. Hartuam një strategji të re për vitet 2010-2013 e cila duhej të ishte në harmoni me prioritetet e Shqipërisë të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZhI) 2007-2013, e cila iu prezantua publikut në fund të pranverës 2010, në prani të zv. Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme. Sfidë ishte edhe kryesimi i Sekretariatit Teknik të Donatorëve gjatë vitit 2010 (bashkë me Austrinë) nga Zvicra në gjysmën e dytë të vitit. E fundit por jo më e pakta,

ishte vizita e Komitetit të Asistencës për Zhvillim (DAC) të OECD-Paris në vitin 2009, kur në kuadrin e një vlerësimi të jashtëm të Zvicrës, përveç Nikaraguas, ata zgjodhën Shqipërinë për vizitën vlerësuese në terren.

Më 30 qershor 2011, Zyra e Bashkëpunimit Zviceran festoi 15-vjetorin e pranisë së saj në Shqipëri. Ky përvjetor u festua me sloganin "Festojmë 15 vjet Bashkëpunim të Frytshëm me Shqipërinë". Çfarë kontributi ka dhënë Qeveria zvicerane dhe ku është përqendruar? Cila ka qenë avantazhi krahasues i asistencës zvicerane?

Një nga paraardhësit e mi (unë isha drejtori i katërt), ngriti Zyrën permanente të Bashkëpunimit Zviceran në një kohë të vështirë trazirash dhe konfuzion politik, kur shumë organizata ndërkombëtare i mbyllën zyrat e tyre. Megjithatë, që nga fillimi i viteve '90, Zvicra ka dhënë vazhdimisht ndihmë *ad hoc*, kryesisht mbi baza humanitare (dhe Ambasada u hap në vitin 1992). Ideja është që të ndihmonim Shqipërinë në mënyrë të përhershme me tranzicionin e saj ndonjëherë edhe të dhimbshëm, si edhe ta mbështetnim në përpjekjet madhore për integrimin evropian.

Në këto dy dekada, përmes dy agjencive të saj, SDC-së (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim) si pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe SECO-s (Sekretariati i Shtetit zviceran për Çështjet Ekonomike) si pjesë e Ministrisë së Ekonomisë, Zvicra i ka akorduar Shqipërisë rreth 150 milion euro në formën e granteve të parimbursueshme. Fokusi afatmesëm dhe afatgjatë është forcimi i institucioneve demokratike dhe

shteti i së drejtës, zbatimi i decentralizimit në nivel vendor dhe rajonal, përparimi i ekonomisë, rritja e punësimit dhe rinovimi i infrastrukturës.

Edhe Zvicra është vend i vogël dhe nuk ka agjendë politike të fshehtë, aq më pak në Shqipëri. Jemi përpjekur të sjellim ekspertizën tonë në fusha si decentralizimi, formimi profesional/punësimi i rinisë (për shkak të sistemit arsimor të dyfishtë), sigurimi i riskut, ujërat e energjia dhe padyshim që kemi arritur njëfarë suksesi (edhe pse ka pasur ndonjë luhatje këto 15 vitet e fundit). Jemi të bindur se kemi partneritet mes të barabartësh, ku të dy palët kanë të drejta të njëjta. Ne i njohim arritjet tona ashtu edhe mësimet e nxjerra.

Cilat janë sipas jush disa nga çështjet më jetike apo arritjet më të rëndësishme? Cilat janë prioritetet specifike të vendit dhe si ndihmon Bashkëpunimi Zviceran në adresimin e tyre?

Ne jemi të mendimit se me Strategjinë aktuale të Bashkëpunimit me Shqipërinë dhe dy shtyllat e saj “Demokratizimi dhe Shteti i së Drejtës” dhe “Zhvillimi Ekonomik”, ne po adresojnë çështjet kyçe të Shqipërisë, si përfshirja sociale e shtresave në nevojë, romët, dhe barazia gjinore. Gjithashtu, siç ka konfirmuar edhe DAC, na jep kënaqësi fakti që Zvicra shihet si partner i besueshëm dhe besnik, si dhe që asistencën jonë konsiderohet si “asistencë e orientuar nga kërkesa, reaguese ndaj nevojave të Shqipërisë, pjesëmarrëse dhe joimponuese”.

Do të vazhdojë Qeveria zvicerane t’i japë Shqipërisë ndihmë dhe asistencë edhe në të ardhmen?

Po, sigurisht. Zvicra është e përkushtuar që të shoqërojë Shqipërinë në rrugën e saj të përparimit. Paralelisht me përpjekjet e Qeverisë për SKZHI-në e ardhshme, pasuesi im do të realizojë një analizë të portofolit zviceran në Shqipëri, që do të jetë e vlefshme për Strategjinë e Bashkëpunimit me Shqipërinë për periudhën nga viti 2014 e tutje. Në kontekstin e perspektivës europiane të Shqipërisë e mbështetur nga një program i gjerë siç është IPA, Bashkëpunimi Zviceran synon të jetë komplementar dhe të japë shumë më tepër ndihmë në të ardhmen.

Në vitin 2010, Zvicra ka qenë anëtare

e Sekretariatit Teknik të Donatorëve dhe gjatë këtij mandati, keni shërbyer si Kryetar i Sekretariatit për 6 muaj (qershor-dhjetor 2010). Çfarë mund të na thoni për këtë përvojë?

Ka qenë një përvojë e pasur, pasi bashkërendimi i donatorëve është kompleks për shkak të këndvështrimeve shpesh të ndryshme për çështjet. Nga ana tjetër, ka qenë një ngarkesë pune e konsiderueshme dhe eprorët e mi ishin disi dyshues që mund të arrija rezultate konkrete. Gjithsesi, besoj se Sekretariati bashkë me Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj po bën një detyrë shumë të rëndësishme, sepse këto takime të rregullta të partnerëve për zhvillim shërbejnë si një platformë e shkëlqyer shkëmbimi idesh, qoftë mes tyre apo me autoritetet. Personalisht, jam përpjekur ta forcoj këtë rol bashkërendues, me shpresën që partnerët më pas të kontaktojnë mes tyre më shpesh dhe më lehtësisht.

Si ju duket zhvillimi i bashkërendimit të donatorëve në Shqipëri dhe roli i Bashkëpunimit Zviceran? Si e shihni rolin e Deklaratës së Parisit dhe të Agjendës së Akrës për Veprim?

DEBASKON-i ka luajtur rol të mrekullueshëm nën drejtimin e drejtores Kuko dhe është përmirësuar vazhdimisht gjatë viteve që kam pasur kënaqësinë të punoj dhe të jetoj në Shqipëri. Ekipi i DEBASKON-it e përvetësoi me mjeshtëri rolin e urës lidhëse me komunitetin donator dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran ka pasur marrëdhëniet e shkëlqyera me ta. Sa për ministrinë e linjës, nuk e dinëse duan ta kuptojnë rolin kyç të DE-

BASKON-it si edhe rëndësinë e madhe që ka zgjerimi i bashkërendimit të donatorëve. Konferenca e radhës në Busan të Koresë nga fundi i vitit 2011, pritet të theksojë rëndësinë e bashkërendimit dhe Zvicra mbetet parimisht mbështetëse e Deklaratës së Parisit dhe e Agjendës së Akrës për Veprim. Megjithatë, pyes veten sa është rëndësia (relative) e këtyre parimeve në kontekste dinamike, p.sh. në Shqipëri ku instrumentet e IPA-s po marrin relevancë dhe rëndësi gjithnjë e më të madhe.

Zvicra është pikë fokale e donatorëve (dhe donatore kryesore europiane) në disa sektorë. Si e shihni rolin e Grupeve Sektoriale të Punës (GSP)?

Zyra e Bashkëpunimit Zviceran vepron si pikë fokale për GSP-në për “Formimin Profesional dhe Punësimin” si edhe për atë të “Decentralizimit dhe Zhvillimit Rajonal”. Dy GSP-të e mëparshme punuan mjaft mirë, sepse dy ministrinë e linjës të përfshira drejtpërdrejtë (Ministria e Arsimit, Ministria e Punës) morën përsipër përgjegjësitë e tyre, por i dyti nuk ishte fort funksional për një sërë arsyesh, kështu që u mjaftua kryesisht me shkëmbimin e informacionit mes donatorëve. Po, në përgjithësi roli ynë si lehtësues është kuptuar, pa zëvendësuar ministrinë e linjës dhe pa marrë ndonjë përgjegjësi të drejtpërdrejtë. Në këndvështrimin tonë, GSP-të luajnë rol plotësisht relevant dhe dëshirojmë që këto organe të jenë aktive në më tepër fusha (p.sh. ne kemi lobuar fort për një GSP që të merret me “Përfshirjen Sociale”). Ato mund të shërbejnë si platformë



e shkëlqyer për dialogun mbi politikat, por ky potencial nuk është shteruar akoma. DEVASKON-i ka përgatitur së fundmi udhëzimet për institucionalizimin e GSP-ve, i cili është një hap i madh në drejtimin e duhur!

Qeveria zvicerane është një prej donatorëve që financon SPI-në (përmes fondit shumëpalësh të besimit). Si po kontribuon SPI-ja në përmirësimin e politikëbërjes dhe bashkërendimit të donatorëve?

Sistemi i Planifikimit të Integruar, SPI, (i administruar nga Banka Botërore) ka rezultuar një mjet tepër i dobishëm, prandaj Zvicra është e gatshme të mbështesë fazën e dytë të tij. Prania, roli dhe funksionimi i mirë i DEBASKON-it, është në vetvete provë e relevancës së SPI-së. Gjithashtu, Shqipëria ka një sistem të sofistikuar strategjik (aktualisht 40 që janë tepër). Fatkeqësisht, jo të gjitha kanë plane veprimi me buxhet, por ato të brezit të dytë dhe të tretë patjetër do të jenë më të rafinuara dhe të orientuara drejt rezultateve, me sisteme monitorimi efikase bazuar në tregues të matshëm që lidhen me procesin e planifikimit të buxhetit.

Si ka qenë përvoja juaj në ofrimin e programeve të asistencës në Shqipëri? Do të veçonit ndonjë projekt si shembullin më të mirë?

Do të ishte e padrejtë të zgjidhja një program apo projekt. Sidoqoftë, sipas mendimit, dhe siç më kanë thënë mjaft zyrtarë shqiptarë, kemi arritur rezultate konkrete në fushën e “Formimit Profesional dhe Punësimit” ky Bashkëpunimi Zviceran është aktiv prej rreth 15 vitesh. Shumë të rinj shqiptarë i kanë hyrë me qejf këtij arsimimi profesional me “frymëzim zviceran”, sepse e shohin që mund të marrin benefite të prekshme për të ardhmen e tyre (më mirë sesa të shkojnë në universitete që shpesh nuk janë të mira).

Zyra juaj zbaton projekte në disa qytete. Keni pasur mundësinë t’i vizitoni?

Vizitat për monitorimin e projekteve më kanë mundësuar që të vizitoheshin qytete të Shqipërisë. Fatkeqësisht, nuk i kam parë të gjitha vendet që doja, si vendet e gërmimeve të Amantias dhe Bylisit që thonë se janë shumë interesante.



Kjo edhe për faktin se nuk kam makinë timen - ndoshta ndër të paktit njerëz në Shqipëri që nuk zotëron një “katërrrotëshe” - kështu që nuk kam lëvizur aq sa kam dashur. Shqipëria është vend me diversitet të pasur dhe me bukuri të jashtëzakonshme, nga jugu në veri dhe nga bregdeti deri te zonat malore. Madje, Bashkëpunimi Zviceran është përpjekur ta vërë në pah këtë fakt përmes një kalendari me foto.

Çfarë ka ndryshuar nga koha e ardhjes tuaj në Shqipëri e deri sot? Çfarë do të mbani mend nga Shqipëria?

Shqipëria do të më kujtohet si një vend i ngrohtë, qoftë për motin, qoftë edhe për mikpritjen e madhe, si edhe për das-

hamirësinë e pakufi të banorëve!

Sigurisht që do të vij prapë për ndonjë vizitë private që të shoh progresin e bërë, i cili ka qenë i konsiderueshëm në këto 4 vitet e fundit dhe shumë aspekte të jetës së përditshme kanë ndryshuar për mirë...

Faleminderit, Daniel dhe të urojmë punë të mbarë dhe sukses në detyrën tënde të re!

Qeveria zvicerane akordon 54.3 milion euro shtesë për forcimin e Pushtetit Vendor në Shqipëri

Qeveria e Zvicrës dhe ajo e Shqipërisë nënshkruan një marrëveshje të re që mbështet forcimin e pushtetit vendor. Ky hap shënon një fazë të re për Programin e Decentralizimit dhe Zhvillimit Vendor (DLDP) i cili kontribuon në forcimin e kapaciteteve të njësive të pushtetit vendor në qarkun e Shkodrës dhe të Lezhës, si edhe në procesin e decentralizimit në Shqipëri.

Më 4 gusht, Ambasadorja zvicerane Sh.S. Yvana Enzler dhe Ministri i Brendshëm, Bujar Nishani nënshkruan sot projekt-marrëveshjen e cila synon të forcojë dhe të përmirësojë funksionimin e pushtetit vendor në veri të Shqipërisë, falë angazhimit financiar prej rreth 5 milion frangash zvicerane (4.5 milion euro) për një periudhë trevjeçare. Sipas marrëveshjes së re, asistencë zvicerane do të fokusohet në forcimin e kapaciteteve të bashkive dhe komunave të Shkodrës dhe Lezhës, gjë e cila rrjedhimisht do të lehtësojë procesin e decen-



Foto: Ambasadorja zvicerane në Shqipëri, Sh.S. Yvana Enzler dhe Ministri i Brendshëm, Bujar Nishani, gjatë nënshkrimit të marrëveshjes që mbështet forcimin e strukturave të pushtetit vendor në veri të Shqipërisë.

tralizimit..

Faza e re do të vazhdojë të zbatohet nga OJF-ja zvicerane Intercooperation që zotëron ekspertizë të veçantë në decentralizim. Bashkitë dhe komunat do të përfitojnë nga shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira si dhe nga ekspertiza zvicerane.

Bashkëpunimi Zviceran i kushton vëmendje të veçantë forcimit të pushtetit vendor dhe përparimit të procesit të decentralizimit në Shqipëri. Në kuadrin e Strategjisë së Bashkëpunimit me Shqipërinë (2010-2013), Zvicra akordon rreth 1/3 e buxhetit për forcimin e pushtetit vendor, shtetin e së drejtës dhe decentralizimin.

Emërohet drejtoresha e re e Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri



Foto: Znj. Isabel Perich, drejtoreshë e sapoemëruar e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri

Emërohet drejtoresha e re në krye të Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri, pas largimit të drejtorit të mëparshëm, Daniel Züst. Znj. Isabel Perich që e mori detyrën në fillim të gushtit, ka punuar në zyrën qendrore të SDC-së në Bernë të Zvicrës dhe ka fituar përvojë të gjerë me punën zhvillimore në Amerikën Latine. Ajo flet rrjedhshëm spanjisht, përveç gjermanishtes, frëngjishtes dhe anglishtes. Emërimi i znj. Perich vjen në një kohë kur SDC dhe SECO, organet financuese të Bashkëpunimit Zviceran, kanë shprehur angazhimin që të vazhdojnë mbështetjen për zhvillimin e Shqipërisë edhe pas vitit 2013.



Foto: Ministri Niebel përuron fillimin e punimeve të projektit "Mbrojtja mjedisore e Liqenit të Shkodrës", i bashkëfinancuar nga Qeveria gjermane përmes KfW-së, Qeveria zvicerane përmes SECO-s dhe Qeverisë austriake përmes ADA-s



Foto: Ministri Gjerman Niebel dhe Kryeministri Sali Berisha në ceremoninë me rastin e përfundimit të punimeve për Linjën e Transmetimit 400kv Shqipëri-Mal i Zi si dhe për Furnizimin me Ujë të Fijshëm, komponenti Berat-Kuçovë

Vizitë në Shqipëri e Ministrin Federal gjerman, Dirk Niebel

Ministri Federal gjerman përuror disa projekte të bashkëfinancuara nga Qeveria gjermane përmes KfW-së

Ministri federal gjerman për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin, Dirk Niebel, zhvilloi një vizitë në Shqipëri në datat 4-6 gusht. Gjatë vizitës, Ministri Niebel përuror fillimin e pro-

jektit "Mbrojtja mjedisore e Liqenit të Shkodrës", i bashkëfinancuar nga Qeveria gjermane përmes KfW-së, Qeveria zvicerane përmes SECO-s dhe ajo austriake përmes ADA-s. Në këto ceremoni ka qenë i pranishëm edhe Kryeministri Sali Berisha. Të tre projektet bashkë-financohen nga Qeveria gjermane përmes KfW Entwicklungsbank me mbi 60 milion euro në total.

Ministri federal gjerman për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin, Dirk Niebel, merr pjesë në Evenimentin për Bashkëpunimin Teknik



Foto: Ministri Niebel gjatë takimit me stafin e GTZ



Foto: Ministri Dirk Niebel me delegacionin e tij duke ndjekur prezantimin

Gjatë vizitës në Shkodër, më 5 gusht 2011, Ministri Dirk Niebel ndoqi prezantimin për Bashkëpunimin Teknik me Shqipërinë. Bashkëpunimi teknik me Shqipërinë ka filluar që në vitin 1988, si pjesë e Bashkëpunimit Gjerman për Zhvillimin. Që atëherë, Qeveria gjermane përmes Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, ka shpenzuar 100 milion euro në projekte të përbashkëta për ngritje kapacitetesh dhe forcim institucional. Fillimisht Gjermania i dha Shqipërisë ndihmë emergjente për bujqësinë, dhe pas viteve '90, asistenca u fokusua në forcimin e institucioneve për ekonominë e tregut moderne, dhe që në vitin 2000, Bashkëpunimi Teknik është fokusuar në një fushë të rëndësishme ndërsektoriale siç është integrimi evropian. Aktualisht, në GIZ-in në Shqipëri punojnë 20 ekspertë ndërkombëtarë afatgjatë dhe 42 punonjës shqiptarë, të cilët mbështeten nga specialistë afatshkurtër sipas nevojave specifike. Fokusi është zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe reforma në sektorin e ujërave, përfshi bujqësinë dhe zhvillimin rural. Ministri Niebel nënvizoi rëndësinë e kombinimit të fushave "tradicionale" të bashkëpunimit me sfidat e reja si mbrojtja e biodiversitetit dhe përshtatja me ndryshimet klimatike.

BE dhe OSBE ndihmojnë autoritetet shqiptare me regjistrimin e zonave bregdetare prioritare

Projekti për regjistrimin e pronave dhe sinjalistikën në zonat bregdetare prioritare të vendit është prezantuar në Tiranë më 21 korrik. Projekti me buxhet 1.5



Foto: Prezantimi i projektit Për regjistrimin e pronave dhe sinjalistikën rrugore në zonat bregdetare prioritare të vendit, të financuar nga BE-ja dhe të zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

milion euro të akorduara nga BE-ja që do të zbatohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, synon të përmbyllë regjistrimin fillestar të pronave si edhe të përditësojë regjistrimet ekzistuese për rreth 60 000 prona në zonat bregdetare nga Palasë Gjoleka deri në veri në Xarë. Ky projekt do t'u mundësojë pronarëve tituj të qartë pronësie dhe do të rritë potencialin për investime në këto zona. Projekti përfshin edhe vendosjen e sinjalistikës së re rrugore në Sarandë, Selenicë dhe Armen, dhe që shpejt do të vendosen edhe në gjashtë zona të tjera (Golem, Qendër Vlorë, Orikum, Lukovë, Delvinë dhe Dhiver) me një kosto prej 103 000 eurosh. Duke folur gjatë prezantimit të projektit, Ambasadori Ettore Sequi, Kryetar i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, tha: "Titujt e qartë të pronësisë dhe siguria juridike janë parakushte thelbësore për zhvillimin e begatë të vendit dhe për thithjen e investimeve të huaja. Vetëm kur një sistem i tillë të jetë funksional, atëherë Shqipëria do të bëhet vend tërheqës për investitorët e huaj, gjë që do të çojë në hapjen

e vendeve të reja të punës." Ambasadori Eugen Wollfarth, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, u shpreh: "Projekti do të ndihmojë Qeverinë për të rritur sigurinë e zotërimit të pronës, që është vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare. Gjithashtu, projekti do të sigurojë një bazë mbi të cilën zyrtarët dhe ligjberësit të formulojnë ligje të përshtatshme, politika dhe procedura për të krijuar tituj pronësie të qartë dhe për të mbrojtur këtë të drejtë."

Projekti mbledh dhe përpunon të dhënat për pronat dhe lehtëson pjesëmarrjen e publikut në një proces transparent që do t'iu sigurojë institucioneve shtetërore informacionet e nevojshme që të përcaktojnë qartë dhe të mbrojnë të drejtën e pronësisë. Projekti u mundëson personave fizikë dhe juridikë të dorëzojnë dokumente dhe të dhëna që demonstronin të drejtën e tyre mbi pronën, si edhe të kërkojnë njohjen juridike të kësaj të drejte. Të gjitha dokumentet dhe hartat e mbledhura dhe të përgatitura në kuadrin e këtij projekti, do t'i dorëzohen Zyrës së Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme. Ky projekt, që ka përfutur fonde shtesë nga qeveritë e Greqisë (100 000 euro), Republikës Çeke (50 000 euro) dhe Zvicrës (30 000 euro), planifikohet të përfundojë në fund të vitit 2011.



Foto: Konferenca Kombëtare "Realizimi i Reformës së Administratës Publike në Shqipëri - Hapat kyç për Integrimin Evropian", e mbajtur më 4 korrik 2011

Realizimi i Reformës së Administratës Publike në Shqipëri - Hapat kyç për Integrimin Evropian

BE jep 1 milion euro për reformën e administratës publike në Shqipëri

Më 4 korrik 2011 u mbajt Konferenca

Kombëtare “Realizimi i Reformës së Administratës Publike në Shqipëri - Hapat kyç për Integrimin Evropian”, në kuadër të projektit prej 1 milion eurosh të financuar nga BE-ja për të mbështetur reformën e administratës publike në Shqipëri.

Ekspertë nga BE-ja dhe autoritetet shqiptare kanë punuar për dy vjet për përgatitjen e ndryshimeve të disa ligjeve kyçe për të siguruar një shërbim civil shqiptar meritokratik, transparent, të përgjegjshëm dhe eficient. Projekti ka sjellë përmirësime edhe në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit dhe në kapacitetet njerëzore të Departamentit të Administratës Publike për të mbikëqyrur reformën. Megjithatë, arritjet korrekte të reformës së administratës publike varen nga vullneti politik për konsensus për miratimin e ligjeve të nevojshme dhe mbi të gjitha, vullneti politik për zbatimin e tyre.

BE-ja po e ndihmon Shqipërinë për përmirësimin e administratës publike për një kohë të gjatë nëpërmjet projekteve të ndërtimit të kapaciteteve në ministri dhe institucione të ndryshme. Mbi 45 milion euro janë dhënë për të mbështetur përpjekjet e Shqipërisë për modernizimin e administratës publike. Vetëm për reformimin e shërbimit publik, janë dhënë 3 milionë euro për të ndihmuar në krijimin dhe forcimin e një shërbimi civil meritokratik, efikas dhe të orientuar ndaj qytetarëve, çka përbën parakusht për zhvillimin e Shqipërisë dhe integrimin në BE. Opinioni i Komisionit Evropian për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim e renditi reformën e administratës publike në listën e 12 prioritetëve që duhen adresuar nga Shqipëria. Opinioni vuri në dukje progres të pamjaf-tueshëm në këtë fushë dhe vuri re mangësi të thella, duke përfshirë lëvizjet e shumta të nëpunësve, praktikën e përhapur të kontratave të përkohshme të punës, mungesën e meritokracisë dhe transparencës në emërimet dhe promovimet, si dhe zbatimin përgjithësisht të dobët të legjislativës.

Ky projekt ka synuar forcimin e kuadrit ligjor dhe krijimin e një sistemi informatik të menaxhimit të burimeve njerëzore (HRMIS) që do të përmirësojë aplikimin e standardeve të meritokracisë dhe përgjegjshmërisë në administratën publike. Në konferencën e zhvilluar sot u paraqitën tre projektakte të rëndësishme: projektligji për Statusin e Nëpunësit Civil, projekt-Kodi i Procedurës Administrative dhe projektligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Publike, dhe u bë thirrje për paraqitjen e sugjerimeve të mundshme si edhe për angazhim të të



Foto: Takimi i Komitetit Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, mbajtur më 1 korrik 2011

gjitha palëve të përfshira në reformën e administratës publike.

Gjatë konferencës, Kryetari i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Ambasadori Etore Sequi theksoi se BE-ja “mund të sjellë ekspertizë për të ndihmuar me hartimin e ligjeve, mund të përmirësojmë infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, mund të trajnojmë stafin etj., por nuk mund t'i miratojmë ne ligjet tuaja. Nuk mund t'i zbatojmë ne ligjet tuaja. Ne nuk mund ta mbikëqyrim apo ta drejtojmë reformën e administratës publike. Këto janë përgjegjësi dhe detyrë e autoriteteve dhe klasës politike shqiptare”. Ambasadori Sequi përfundoi fjalën e tij duke vënë në dukje se: “Kjo Konferencë ofron një mundësi të rëndësishme për të treguar vullnetin e përfurcuar politik për të ecur përpara me vendosmëri në fushën e reformës së administratës publike. BE-ja pret që qeveria të angazhohet në një proces të gjerë konsultimi, duke përfshirë opozitën, me synim arritjen e konsensusit të nevojshëm për projektligjet e reja dhe miratimin e tyre në Kuvend”.

UNODC mbështet përpjekjet e Shqipërisë kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore organizoi një takim në Tiranë më datë 1 korrik 2011, me tre objektiva: shpalljen e Planit kombëtar të Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2011-2013; diskutimin dhe rishikimin e Raportit Vjetor 2010 të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore; dhe planifikimi i masave të mëtejshme për luftën kundër trafikimit. Në takimin e kryesuar nga zv. Minis-

trja e Brendshme/Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, nderuan me pjesëmarrjen e Kryeministri Sh.T. Sali Berisha. Të pranishëm ishin edhe Ministri i Brendshëm, z. Bujar Nishani; zv. Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta; Prefekti i Tiranës; përfaqësues të pushtetit vendor; ekspertë vendas dhe përfaqësues OJF-sh. Në takim morën pjesë edhe Ambasadori i Italisë në Shqipëri, Sh.T. Saba D’Elia, zv. Shefja e Misionit të Ambasadës së ShBA-së në Tiranë, Deborah Jones, Koordinator i Rezidentit i OKB-së/Përfaqësues i UNICEF-it, Detlef Palm si edhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare. Takimin e hapin znj. Iva Zajmi, zv. Ministre e Brendshme/Koordinator Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore e cila prezantoi Planin kombëtar të Veprimit në mënyrë të përmbledhur. Znj. Zajmi tha se Plani i ri i Veprimit ofron mundësi të reja për qasje ndërdisiplinore dhe do të kontribuojë në kapërcimin e vështirësive të hasura gjatë zbatimit të strategjisë së mëparshme kombëtare. Znj. Zajmi gjithashtu deklaroi se Plani i Veprimit shërben si lokomotivë për të përmirësuar përpjekjet e Shqipërisë kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Në fjalën e tij, Kryeministri Berisha e quajti trafikimin e njerëzve formë më e turpshme që meriton ndëshkim. Ai tha se Plani i ri i Veprimit ishte dëshmi e qartë e vullnetit të Qeverisë shqiptare për luftë pa kompromis kundër trafikimit në njerëz. Kryeministri u bëri thirrje autoriteteve shqiptare të lexojnë mirë raportin e fundit TIP (TIP - Trafikimi në Njerëz) të Departamentit të Shtetit amerikan dhe të shndërrojnë rekomandimet e tij në veprime. Kryeministri Berisha gjithashtu nën-

vizoi se Shqipëria do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me aktorët rajonalë dhe ndërkombëtarë për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Fjalime mbajtën edhe Ministri i Brendshëm, Ambasadori italian dhe zv.Shefja e Misionit të Ambasadës së ShBA-së. Në bazë të diskutimeve të zhvilluara nga të pranishmit, takimi u përmbyll me këto rekomandime:

- Të forcohen strukturat ekzistuese kundër trafikimit të qenieve njerëzore, sidomos ato vendore, përfshi rolet e Komiteteve Vendore kundër trafikimit të qenieve njerëzore;
- Të zbatohen Procedurat Operative standard për identifikimin dhe referimin e viktimave dhe viktimave potenciale të trafikimit;
- Të forcohet Mekanizmi Kombëtar i Referimit;

Të forcohen rrjetet kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe roli i OJF-ve në luftën kundër këtij trafikimi.

Publikimi i Planit kombëtar të Veprimit dhe i Raportit Vjetor 2010, si edhe takimi i Komitetit Shtetëror janë mbështetur nga zyra e Projektit UNODC në Tiranë, në kuadrin e zbatimit të Projektit ALB/G70 të financuar nga Qeveria italiane.

Përfaqësia e Francës në Zyrën e OKB në Vjenë financon për hapjen e një sale këshillimi për viktimat e trafikimit

Marrëveshja u nënskrua nga Ministri i Brendshëm Z. Bujar Nishani dhe Ambasadorja e Francës Znj. Maryse Daviet më 10 gusht 2011



Foto: Nënskrimi i Marrëveshjes për hapjen e një sale këshillimi për viktimat e trafikimit nga Ministri i Brendshëm Z. Bujar Nishani dhe Ambasadorja e Francës Znj. Maryse Daviet

Përfaqësia e Përhershme e Francës pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Vjenë do të finançojë hapjen dhe funksionimin e një sale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Tiranë për të këshilluar dhe ndihmuar viktimat e mundshme të trafikut të qenieve njerëzore, kryesisht gratë dhe fëmijët. Marrëveshja për këtë financim u nënskrua sot në Ministrinë e Brendshme nga Ministri i Brendshëm Z. Bujar Nishani dhe Ambasadorja e Francës në vendin tonë Znj. Maryse Daviet. Bazuar në prioritetin e madh që ka në këtë çështje qeveria shqiptare, Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, krahas angazhimeve institucionale, krahas bashkëpunimit me një numër organizatash të shoqërisë civile të cilat ofrojnë kontributin e tyre në këtë fushë, mirëprejt dhe vlerëson të gjithë angazhimet dhe kontributet e partnerëve ndërkombëtarë për të asistuar, për të bashkëpunuar pikërisht në një çështje që është fundamentale për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, -u shpreh Ministri Nishani.

Duke falenderuar dhe shprehur mirënjohjen për angazhimin e Përfaqësisë së Francës pranë zyrës së OKB në Vjenë, e po kështu edhe të ambasadës franceze për finalizimin e kësaj marrëveshjeje, Ministri Nishani garantoj se partneriteti do të sjellë rezultate më të mira në përballimin e fenomenit të trafikut të qenieve njerëzore.

“Tek Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit do të gjeni një partner serioz dhe dinamik në angazhimin për të përballuar një sfidë që është shumë e rëndësishme sot për çdo shoqëri, për çdo vend, për të luftuar që në themel pjesën e trafikimit, por edhe atë që është pjesa tjetër e këtij fenomeni dhënien e ndihmës, dhënien e asistencës, proceset e rehabilitimit dhe të riintegritimit të viktimave të mundshme të këtij trafiku”, deklaroi Ministri Nishani.

Ambasadorja e Francës në Shqipëri Znj. Maryse Daviet u shpreh në fjalën e saj se marrëveshja e sotme konfirmon bashkëpunimin mes qeverive të të dy vendeve për të forcuar më tej luftën kundër fenomenit të trafikut të qenieve njerëzore dhe për të



Fjala e hapjes e Kryeministrit Sali Berisha në prezantimin e projektit që ka si qëllim projektimin dhe krijimin e një rrjeti telematik/kompjuterik mes institucioneve akademike shqiptare, organizuar nga Kooperacioni Italian për Zhvillim më 22 korrik 2011

përmirësuar asistencën ndaj viktimave të trafikut për integrim më të lehtë të tyre në shoqëri në një fazë të dytë. -Salla që do të funksionojë për asistencën ndaj viktimave të trafikut do të jetë e njëjtë si në Francë dhe roli i saj nuk ka të bëjë vetëm me luftën dhe përpjekjet kundër fenomenit të trafikimit, por edhe me respektimin e të drejtave të minoreneve, -u shpreh ambasadorja Daviet.

Kooperacioni Italian për Zhvillim investon për didaktikën dhe kërkimin shkencor universitar

Më 22 korrik, Kooperacioni Italian për Zhvillim prezantoi projektin që ka si qëllim projektimin dhe krijimin e një rrjeti telematik/kompjuterik mes institucioneve akademike shqiptare. Kjo konferencë prezantimi u hap nga Kryeministri Sali Berisha. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është që universitetet dhe institucionet kërkimore të arrijnë standardet e BE-së. Ky rrjet i ri TIK, i mundëson sistemit akademik të ofrojë shërbime të reja administrative dhe didaktike, si për studentët, ashtu dhe për studiuesit, duke u rritur kështu cilësia e mësimdhënies dhe e nxënies. Rrjeti telematik do të rrisë edhe bashkëpunimin mes profesorëve dhe studiuesve shqiptarë dhe europiane në lidhje me aktivitetet kërkimore. Kooperacioni Italian akordon gran-

tin prej 4 milion eurosh për këtë nismë, si mbështetje buxhetore e drejtpërdrejtë për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Për zbatimin e këtij projekti, Ministria do të mbështetet me asistencë teknike nga dy konsorciume universitetesh italiane, CIN-ECA dhe CASPUR.

Kryeministri theksoi rëndësinë e kësaj nisme, duke rikujtuar se performanca e sistemit akademik është jashtëzakonisht e rëndësishme për Shqipërinë, për shkak se zhvillimi i vendit është i lidhur drejtpërdrejt me formimin e studentëve të nivelit të lartë dhe të studiuesve, si edhe me rritjen e kërkimit shkencor dhe teknologjik.

Në konferencë morën pjesë ministri i Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj; zv. Ministria Nora Malaj; Ambasadori italian në Tiranë, Saba D'Elia; Drejtori i Kooperacionit Italian, Aldo Sicignano; dhe shumë përfaqësues të institucioneve akademike shqiptare dhe italiane.



■ Foto: (nga e majta në të djathtë) Zv. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Nora Malaj; Kryeministri Sali Berisha; Drejtori i Kooperacionit Italian, Aldo Sicignano; Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj; dhe Ambasadori italian në Tiranë, Saba D'Elia

“Mbështetje dhe Zgjerim i Sistemit të Thesarit në Shqipëri - SETS”, projekti i ri financuar nga IPA dhe i zbatuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim

Ministria e Financave dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) organizuan evenimentin e shpalljes së projektit *Mbështetje dhe Zgjerim i Sistemit të Thesarit në Shqipëri - SETS* në fillim të korrikut, për të paraqitur objektivat specifike dhe konstatimet nga faza fillestare e projektit SETS. Ky eveniment synonte edhe që të konceptoheshin opsionet kryesore për zmadhimin dhe zgjerimin e Sistemit



■ Foto: Nezir Haldeda, zv. Ministër i Financave; Aneil Singh, Shef i Njësisë Operacionale të Delegacionit të BE-së; Astrid Wein, Shefe e Agjencisë Austriake për Zhvillim; Alexandra Fehlinger Drejtuese e projektit SETS, gjatë shpalljes së projektit

të Thesarit në Shqipëri. “Ky është një projekt sa i rëndësishëm, po aq edhe delikat për t’u zbatuar. Po ashtu, është sfidues, sepse kërkon prej institucioneve zbatuese pjekuri në hedhjen e këtij hapi të rëndësishëm si pjesë e menaxhimit të financave publike”, theksoi z. Haldeda gjatë fjalës së tij.

Objektivi kryesor i projektit është të kontribuojë në forcimin e menaxhim-

it të financave publike në përputhje me dokumentin e Partneritetit European dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, dhe në veçanti, të forcijë kapacitetet e Ministrisë së Financave (MF), ministrive të linjës dhe bashkive të mëdha, për të siguruar menaxhim optimal financiar të burimeve publike si dhe të zgjerojë rrjetin midis MF-së, Degëve të Thesarit, ministrive të linjës dhe bashkive të përzgjedhura, ku së bashku të lidhen rreth 50 institucione buxhetore.

Gjatë muajit korrik, ekipi i projektit SETS bashkë me homologët e projektit në MF, realizuan disa aktivitete të parashikuara për fazën fillestare, si: seminari me përfaqësuesit e MF-së për të përcaktuar qartë procesin e punës së Sistemit të Thesarit (1 korrik); seminari për zgjerimin e procesit të punës deri te institucionet buxhetore (15 korrik); takimi i nivelit të lartë teknik me përfaqësues të MF-së dhe të institucioneve buxhetore mbi opsionet për zgjerimin e sistemit aktual të thesarit (në 27 korrik); dhe tryeza e rrumbullakët bankat tregtare, Bankën e Shqipërisë dhe MF-në, për mundësitë e mbledhjes së centralizuar të të ardhurave (29 korrik).

Më 27 korrik, projekti SETS organizoi një takim të nivelit të lartë teknik me përfaqësues të MF-së, ministrive të linjës dhe bashkive të mëdha, ku u prezantuan konstatimet kryesore dhe u diskutua me aktorë të rëndësishëm opsionet për zgjerimin e sistemit të thesarit. Gjatë takimit, ekspertët prezantuan alternativa për përmirësimin e parashikimit dhe menaxhimit të *cash*-it në sistemin e thesarit të Ministrisë së Financave dhe rritjen e kapaciteteve raportuese, si dhe alternativa të ndryshme për zgjerimin e aksesit në sistemin aktual të thesarit duke përfshirë institucione buxhetore (opsionet TI funksionale dhe rritja e aksesit në rrjet).



■ Foto: Fernando Fernandez. Ekspert i Thesarit duke prezantuar konstatimet paraprake në takim teknik të 27 korrikut 2011



Lançohet Raporti i Investimeve Botërore 2011

Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte (IHD) në Shqipëri tejkalojnë për herë të parë 1 miliard USD

Më 1 gusht 2011, Konferenca e OKB-së për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD) prezantoi Raportin e Investimeve Botërore 2011. Sipas raportit, Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Shqipëri u rritën për herë të parë në mbi 1 miliard USD në vitin 2010, duke u bërë vendi i dytë në Europën Juglindore, pas Serbisë, që thith më shumë IHD.

Fluksi i IHD-së në Europën Juglindore ra me 47% në vitin 2010, pjesërisht si rezultat i rënies së investimeve nga vendet e BE-së (burimi kryesor tradicional i IHD-së në rajon). Në veçanti, Greqia që ka qenë portë ose përcjellëse e investitorëve të huaj në Europën Juglindore, nuk ishte më pikë hyrjeje pas përkeqësimit të krizës së brendshme ekonomike. Fluksi i IHD-së në Kroaci dhe Serbi ra ndjeshëm në vitin 2010. Raporti i Investimeve Botërore 2011 tregon se flukset e IHD-së në botë u rritën lehtë gjatë vitit 2010, por mbetën rreth 15% nën mesataren e parakrizës. Raporti parashikon se në dy vitet në vijim, me përjashtim të ndonjë tronditjeje të paparashikuar ekonomike, flukset e IHD-së di të përmirësohen duke kapur vlerën e parakrizës. Promovimi dhe lehtësimi i investimeve vazhdojnë të mbeten elementë dominues në politikën kombëtare të investimeve. Megjithatë, rreziku i proteksionizmit ndaj investimeve është rritur si rezultat i akumulimit gjatë viteve të fundit të masave kufizuese ndaj investimeve dhe

procedurave administrative.

Raporti i sivjetshëm fokusohet në modelin e biznesit “pa pjesëmarrje në aksione” të prodhimit ndërkombëtar. Këto modele paraqesin mundësi për ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion për t’u integruar më mirë në ekonominë botërore, për të forcuar potencialin e kapaciteteve prodhuese vendase si dhe për të përmirësuar konkurrencën ndërkombëtare. Raporti tregon si dhe pse këto modele biznesi si prodhimi me elementë të kontraktuar, nënkontraktimi i shërbimeve, kontraktimi i fermave, franciza dhe licencimi po përdoren gjithnjë e më shumë nga korporatat shumëkombëshe në menaxhimin e zinxhirit global të krijimit të vlerës. Aktivitetet ndërkufitare në mbarë botën të lidhura me këto modele biznesi janë domethënëse dhe veçanërisht të rëndësishme për vendet në zhvillim. Për shembull, në vitin 2010, ato gjeneruan rreth 2 trilion dollarë shitje në botë, punësuan rreth 14-16 milionë punonjës në vendet në zhvillim, dhe në disa industri përbënin rreth 70-80% të eksporteve botërore. Raporti studion faktorët shtytës të rritjes së këtyre modeleve të biznesit, shkallën, qëllimin, ndikimin që kanë në fushën e zhvillimit si dhe politikën nxitëse.

Përurohen pikat e kalimit kufitar dhe stacionet e Kufirit të Gjellbër

Delegacioni i BE-së në Tiranë përuroi ndërtimin e 10 pikave të kalimit kufitar dhe rinovimin e 17 stacioneve të policisë kufitare, në kuadrin e Projektit të CARDS 2006 “Menaxhimi i Integruar i Kufijve” me vlerë 5.5 milion euro. Në ceremoninë e rastit të zhvilluar më 22 korrik

2011 në Pogradec, morën pjesë Ministri i Brendshëm, Bujar Nishani, Ministri i Financave, Ridvan Bode dhe Kryetari i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Ettore Sequi, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Hysni Burgaj dhe zv. Drejtori i Përgjithshëm për Kufirin dhe Migracionin, Pëllumb Nako.

Gjatë përuimit, Kryetari i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Ambasadori Ettore Sequi, theksoi se lufta kundër krimit të organizuar është një prej 12 prioritetëve të BE-së për Shqipërinë. Më pas ai shtoi: “Siç e shohim edhe këtu në Tushemisht, infrastruktura tashmë është e përmirësuar. Ato që dikur ishin kontenerierë të vjetër dhe kioska, tani janë objekte europiane moderne që i mundësojnë policisë dhe doganave të punojnë sipas standardeve të Shengenit dhe praktikave më të mira të BE-së”. Ambasadori Sequi shtoi se infrastruktura, edhe pse është thelbësore, nuk mjafton për t’i bërë kufijtë e Shqipërisë më pak poroze. Gjatë përuimit, Kryetari i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Ambasadori Ettore Sequi, theksoi se lufta kundër krimit të organizuar është një prej 12 prioritetëve të BE-së për Shqipërinë. Më pas ai shtoi: “Siç e shohim këtu në Tushemisht, infrastruktura tashmë është e përmirësuar. Ato që dikur ishin kontenerierë të vjetër dhe kioska, tani janë mjedise pune moderne europiane që i mundësojnë policisë dhe doganave të punojnë sipas standardeve të Shengenit dhe praktikave më të mira të BE-së”. Ambasadori Sequi shtoi se infrastruktura, edhe pse është thelbësore, nuk mjafton për t’i bërë kufijtë e Shqipërisë më pak porozë. “Vendosmëria dhe vullneti i autoriteteve shqiptare duhet t’i bëjnë këto arritje të qëndrueshme”, tha ai.

Menaxhimi i kufijve është përcaktues për forcimin e shtetit të së drejtës dhe



Foto: Ministri i Brendshëm, Bujar Nishani; Ministri i Financave, Ridvan Bode; dhe Kryetari i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Ettore Sequi gjatë inaugurimit të pikës së kalimit kufitar Tushemisht, Pogradec

luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikëve. Shqipëria ka bërë progres në sigurimin e kufijve - sidomos në kuadrin e procesit të liberalizimit të vizave – me qëllim që t'i bëjë ato më pak të përshkueshme nga kriminaliteti. BE-ja i ka dhënë Shqipërisë mbështetje të madhe për këtë proces, përmes përmirësimit të infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Paralelisht me ndërtimin dhe rinovimin e stacioneve të policisë kufitare dhe të pikave të kalimit kufitar, BE-ja përmes Projektit PAMECA me vlerë 7 milion euro që ndihmon Policinë e Shtetit, i ka mundësuar kësaj të fundit të njihet me praktikën më të mira europiane. Aktualisht, BE po bashkëpunon me autoritet shqiptare për të përafruar më tej procedurat e punës të Policisë së Kufirit dhe Migracionit me ato të BE-së, për të përmirësuar shërbimin sekret në kontrollin kufitar si dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional.

2.2 milion euro në mbështetje të sipërmarrjes së femrave në Europën Juglindore

Më 14 korrik 2011, Sekretariati i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA) nënshkruan në Sarajevë një marrëveshje me vlerë 2.2 milion euro, e cila synon të nxitë shpirtin sipërmarrës të femrave në Europën Juglindore përmes bashkëpunimit mes sektorit publik dhe privat. Projekti “Sipërmarrja e femrave – lokomotiva e krijimit të vendeve të punës për Europën Juglindore” do të promovojë politikën dhe praktikën më të mira për sipërmarrjen e femrave, si edhe mbështetjen për forcimin e kapaciteteve të shoqatave të grave sipërmarrëse në Europën Juglindore. Nën mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e RCC-së, projekti do të zbatohet nga dy organizata rajonale: Qendra e Europës Juglindore për Mësimet e Sipërmarrjes (SEECCEL) dhe Task Forca Gjinore (GTF). Faza konceptuese e projektit fillon menjëherë, por zbatimi i plotë do të realizohet përgjatë 3 viteve, 2012-2014. Projekti pasqyron qartë prioritetet e RCC-së në fushën e zhvillimit ekonomik dhe social, siç parashikohet në Strategjinë dhe Programin e Punës të RCC-së për periudhën 2011-2013: promovimi i një hapësire të vetme investimesh përmes Komitetit të Investimeve të Europës Juglindore, identifikimin e mënyrave për të përmirësuar aksesin në



Foto: Prezenca e OSBE-së u shpërnda certifikatat nëpunësve ministrorë që merren me barazinë gjinore

financime, si edhe futja e punësimit dhe agjendës sociale gjatë përgatitjes së reformave ekonomike.

Prezenca e OSBE-së diplomon nëpunësit ministrorë që merren me barazinë gjinore

Më 14 korrik, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSH) zhvilluan në Tiranë ceremoninë e diplomimit të nëpunësve ministrorë që merren me barazinë gjinore, të cilët ndoqën një kurs të avancuar në Vlorë më 23-24 qershor, mbi integrimin e çështjeve gjinore në programet dhe politikën shtetërore. Në këtë ceremoni morën pjesë Kryetari i Prezencës së OSBE-së, Ambasadori Eugen Wollfarth, Ministri i MPÇSSH, Spiro Ksera, zv. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Nora Malaj, zv. Ministria e Brendshme, Iva Zajmi, zv. Ministria e Brendshme, Zana Xhuka, zv. Ministria e Punës, Filloreta Kodra dhe zv. Ministri i Financave, Nezid Haldeda. Ky dhe evente të tjera janë pjesë e projektit të përbashkët të Prezencës së OSBE-së për vitin 2011, i quajtur “Mbështetja e funksionimit efektiv të mekanizmit të barazisë gjinore në Shqipëri”.

Seminar për hetimin e aseteve kriminale

Tre seminare për Hetimin e Aseteve Kriminale u zhvilluan gjatë periudhës 12-14 korrik 2011, ku merrnin pjesë zv. Drejtorët e Drejtorive të Policisë në Qarqe, Drejtuesi i Sektorit kundër Lëndëve Narkotike dhe Drejtuesi i Sektorit kundër Trafikut të Paligjshëm. Qëllimi i seminareve ishte konsolidimi i punës së mirë -

që po bëhet që nga zhvillimi i tre seminareve të mëparshme në mars të këtij viti dhe nga diskutimet e tavolinës së rumbullakët të qershorit - si edhe informimi i specialistëve të hetimit të krimit të organizuar mbi avantazhet e hetimit të pasurive kriminale, si një mjet i fuqishëm në luftën kundër krimit të organizuar. Pjesëmarrësve iu paraqit një draft “formular raportimi paralel” me formatin e sugjeruar, të përgatitur nga eksperti afatshkurtër pranë Misionit PAMECA III, z. Stephen Maxwell, dhe i cili u ndryshua pak nga Sektori për Hetimin e Aseteve Kriminale në Policinë e Shtetit. Qëllimi ishte që sapo ky projekt-formular të miratohet dhe të kthehet në Procedurë Standarde Pune, specialistët e hetimit të krimit të organizuar duhet të plotësojnë formularin në çdo rast kur fillojnë një hetim kundër një bande të krimit të organizuar dhe pastaj t’ia dorëzojnë këtë formular Sektorit për Hetimin e Aseteve Kriminale në Policinë e Shtetit.

Z. Leonard Peace, Këshilltar afatmesëm kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, pranë Misionit PAMECA III dhe z. Stephen Maxwell, Ekspert afatshkurtër për Hetimet Financiare, pranë Misionit PAMECA III, i ofruan pjesëmarrësve përvojën e tyre në Shërbimin Policor të Irlandës së Veriut. Të dy theksuan faktin që, megjithëse policia dhe prokuroria nuk mund të jenë gjithmonë të suksesshme me procedimet penale, rikuperimi i aseteve kriminale në procedimet civile ka qenë një mjet shumë i suksesshëm për të goditur dhe parandaluar aktivitetin e bandave kriminale.

Drejtuasi i Sektorit për Hetimin e Aseteve Kriminale në Policinë e Shtetit, z. Lorenc Paganika, ofroi për pjesëmarrësit shpjegime për Ligjin “Anti Mafia” në lidhje me parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikëve nëpër-

mjet masave parandaluese ndaj aseteve, si edhe i nxitit të bashkëpunojnë me Seksionet për Hetimin e Aseteve Kriminale në Drejtoritë e Policisë të Qarqeve që në fillimin e kryerjes së hetimeve. Z. Adnan Xholi, Prokuror në Prokurorinë e Krimeve të Rënda ofroi për pjesëmarrësit njohuri dhe këshilla të dobishme bazuar në përvojën e tij në lidhje me zbatimin e Ligjit "Anti Mafia" dhe problemet me të cilat është përballur.

Konferenca me temë "Brain drain – Brain gain"

"Shoqata e Bursistave të DAAD-së" organizoi në datat 4 dhe 5 korrik 2011 Konferencën me temë "Brain drain – Brain gain". Ishin të pranishëm edhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës z. Myqerem Tafaj, Rektori i Universitetit të Tiranës z. Dhori Kule, Ambasadorja Gjermane në Tiranë znj. Carola Müller-Holtkemper, Menaxheri i programit Brain Gain të PNUD-it, z. Bernard Zeneli, përfaqësues të DAAD në Bonn, z. Peter Hiller, DAAD-Alumni si dhe përfaqësues Universiteteve dhe Organizatave jo-fitimprurëse që operojnë në këtë fushë. Tema- Migrimi i ekspertëve si dhe kthimi e riintegrimi i tyre në tregun vendas të punës - është temë kryesore për zhvillimin e mëtejshëm të Shqipërisë. Në Konferencë përveç studimeve shkencore dhe prezantimit të "Alumniportal Deutschland" u paraqitën edhe referime nga përvojat e emigrimit të akademikëve shqiptarë jashtë vendit. Lidhur drejtpërdrejt me këto referime ishte edhe diskutimi permbyllës mbi problemet praktike të riintegritimit si në universitete ashtu edhe në tregun e punës në përgjithësi. Në një bllok të dytë u prezantua dhe u diskutua rreth strategjive për rikthimin në vend të akademikëve si dhe integrimin e tyre në strukturat e shoqërisë shqiptare. Ndër të tjera u treguan mundësitë që ju ofrohen grupeve të interesuara si dhe u shkëmbyen përvojat e deritanishme.

Programi *Brain Gain*, i financuar nga PNUD-i, ka mbështetur qeverinë në krijimin e elementeve nxitës dhe të mekanizmave politikëbërës për të ndryshuar efektivisht angazhimin e diasporës shqiptare në zhvillimin shkencor, administrativ dhe ekonomik të vendit. Programi ka mbështetur me përgatitjen e një kornize politikash për proceset e mësipërme. Një sërë ligjesh janë amenduar duke synuar një proces sa më të efektshëm dhe të qëndrueshëm për të rikthyerit në Shqipëri. Programi *Brain Gain* eksploron



Foto: Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj, Ambasadorja Gjermane, Carola Müller-Holtkemper, dhe Rektori i Universitetit të Tiranës, Dhori Kule në konferencën "Brain drain – Brain gain", organizuar më 4 dhe 5 korrik 2011



Foto: Menaxheri i Programit "Brain Gain" të financuar nga PNUD-i, Bernard Zeneli në konferencën "Brain drain – Brain gain", organizuar më 4 dhe 5 korrik 2011

mundësitë për krijimin e punësimit dhe ato të tregut të punës në Shqipëri për të siguruar për qeverinë shqiptare një strategji afatgjatë të punësimit dhe krijimit të vendeve të punës. Gjatë katër viteve të tij ky program ka kërkuar të shndërrojë procesin e "rrjedhjes së trurit".

Prezenca e OSBE-së mbështet Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Policinë e Shtetit për administrimin e zgjedhjeve të pjesshme

Më 28 korrik, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri i dha hua një numër telefonash satelitorë Policisë së Shtetit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në mbështetje të veprimtarisë së tyre në zonat e thella rurale gjatë zgjedhjeve të pjesshme vendore më 31 korrik 2011. Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadori Eugen Wollfarth deklaroi: "Pajisjet do të mbështesin kapacitetet komunikuese të institucioneve shqiptare gjatë zgjedhjeve të pjesshme vendore edhe në zonat më të

thella, në të cilat mungon mbulimi i plotë i rrjeteve të telefonisë celulare. Çdo qytetar shqiptar gëzon të drejtën e votës dhe që vota e tij ose e saj të numërohet, pavarësisht nëse vota hidhet në qytet apo në një zonë të thellë," shtoi Wollfarth.

Përveç sigurimit të pajisjeve, Prezenca e OSBE-së u zotua se do të mbulojë kostot e komunikimit për administrimin e këtyre zgjedhjeve të pjesshme. Kjo mbështetje iu ofrua edhe Policisë së Shtetit gjatë zgjedhjeve vendore të 8 majit 2011. Asistenca ofrohet në kuadrin e mbështetjes së vazhdueshme të Prezencës për institucionet e shtetit shqiptar për të bërë të mundur administrimin e suksesshëm teknik të procesit zgjedhor.

Projekti i UNODC mbështet Trajnimin e punonjësve të kufirit për Vlerësimin e Riskut

Për të maksimizuar efektivitetin parandalues dhe operacional të Doganave dhe Policisë Kufitare, Zyra e Projektit UNODC në Tiranë ka sponsorizuar dy kurse

trajnimi mbi riskun për punonjësit e kufirit. Kursi i parë i zhvilluar në Tiranë në tetor 2010, ishte teorik dhe fokusohet në risqet e trafikut të narkotikëve në Europë dhe në botë, prirjet dhe metodat e fshehjes, si edhe në demonstrimin e teknikave më të fundit zbuluese dhe zbatuese që përdoren nga nëpunësit kufitarë (16 në total) në punën e përditshme. Ky kurs teorik u pasua nga një kurs praktik i organizuar në Danimarkë me pjesëmarrjen e katër oficerëve kufitarë: dy punonjës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe dy nga Drejtoria e Policisë së Kufirit dhe Migracionit. Kursi i mbajtur më 31 korrik-5 gusht 2011, u zhvillua në Autoritetin Tati-mor Danez (doganat janë pjesë e këtij autoriteti)

Gjatë vizitës në Aeroportin e Kopenha-genit, në Portin e Arhusit dhe Padborgut (kufiri danezo-gjerman), oficerët shqiptarë u njohën me analiza të thelluara krahasuese në lidhje me sfidat dhe sukseset e organeve daneze të zbatimit të ligjit, në luftën e tyre kundër krimit ndër-kufitar. Kursi eksplori edhe modelet të ndryshme të bashkëpunimit mes policisë dhe doganave daneze për të rritur performancën përmes informacionit sekret kriminal, dhe se si përdoret ky informacion në përzgjedhjen e ngarkesave, udhëtarëve dhe automjeteve. Pjesëmarrësit asistuan edhe në situata “të gjalla” kur po kryeshin kontrolle/ekzaminime fizike të kontenierëve të përzgjedhur nga ekipi i skanerëve. Kjo ishte një mundësi e mirë për ekipin shqiptar që të punojnë bashkërisht me autoritetet daneze dhe të shkëmbejnë përvojën me ta. Në kuadrin e zbatimit të Projektit ALB/G70 të financuar nga Qeveria italiane, UNODC po kontribuon për përgatitjen e një programi mësimor për vlerësimin e riskut, një metodë relativisht e re kjo që i shërben kryesisht punës së policisë kufitare.

Manuali “MENAXHIMI ME BAZË REZULTATET” për njësitë e qeverisjes vendore

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim ka prezantuar me 12 Korrik në Konferencën Kombëtare manualin mbi menaxhimin Menaxhimin me Bazë Rezultatet, si një praktikë qeverisëse për përmirësimin e efektshmërisë së menaxhimit dhe administrimit një njesite e qeverisjes vendore. Investimi në këto metodologji menaxheriale të bashkive dhe institucioneve të tjera publike përmbush kërkesën së publikut për më tepër përgjegjshmëri dhe



Foto: Projekti i UNODC mbështet Trajnimin e punonjësve të kufirit për Vlerësimin e Riskut

efikasitet në administrimin e të mirave publike dhe kryerjen e shërbimeve sa më cilësore bazuar në një raport të drejtë kosto-përfitim. Kjo qasje e re në menaxhimin publik është e rekomanduar gjithashtu, në kushtet kur kriza financiare dhe ekonomike ka ulur nivelin e burimeve në dispozicion të vendimmarrësve publikë, pasi ndihmon të racionalizosh burimet dhe ti përdorësh ato për të arritur rezultate të prekshme për qytetarët me një impakt real në jetën e tyre. MBR-ja fokuson kryesisht një praktikë pune, që shikon drejt arritjes së rezultateve konkrete në çdo politikë apo veprim që ndërmerr administrata publike, përkundrajt fondeve publike dhe miradministrimin e tyre në shërbim të ob-jektivave dhe interesave publike vendore. Përveç kësaj, Menaxhimi me Bazë Rezultatet, imponon një disiplinë dhe kulturë të caktuar menaxheriale e cila duke synuar rezultatet e prekshme, bën të mun-

dur monitorimin dhe vlerësimin e performancës në arritjen e rezultateve duke paraprirë dhe anashkaluar rreziqet në rrugën e arritjes së tyre.

IDN e ka ndërmarrë këtë përpjekje serioze me synim afatgjatë, për të sjellë një eksperiencë të re në praktikën shqiptare të menaxhimit publik me fokusin primar qeverisjen vendore por që do duhet të gjejë zbatim edhe për nivele të tjera të qeverisjes. Në përfundim të konferencës kombëtare përfaqësuesit e shume njësive vendore e vlerësuan manualin e prezantuar dhe gjithashtu përfaqësues të donatorëve që punojnë me njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri u shprehën për mundësitë për të financuar zbatimin kësaj qasjeje në disa njësi vendore pilote.

Aktiviteti u pershendet nga zv Ministri i Brendshëm Ferdinand Poni dhe Drejtore e Departamentit të Koordinimit të Strategjive dhe Ndihmes së Huaj zj Valbona

Kuko. Realizimin i këtij projekti u mundësua nga Balkan Trust for Democracy dhe Fondacioni Friedrich Ebert në Tirana.

Trajnimi i dytë *Treatnet* për profesionistët në Shqipëri

Zyra e OKB-së kundër Drogës dhe Krimit (UNDOC) dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) organizuan një trajnim për Trajtimin Psikosocial, i cili përbënte Trajnimin e dytë *Treatnet* të Profesionistëve në Shqipëri. Trajnimi u zhvillua në Institutin e Shëndetit Publik në datat 7-8 korrik 2011 dhe morën pjesë 18 profesionistë nga shërbimi i kujdesit parësor, drejtoritë rajonale të shëndetësisë dhe administrata e burgeve. Kursi eksploroj mjete psikosociale dhe teknikat që mund të përdoren gjatë punës me personat e varur nga droga. Kursi përfshinte çështje si biologjia e varësisë nga droga, parimet kryesore të trajtimit ndaj drogës, këshillimi psikosocial dhe përfshirja e anëtarëve të familjes në trajtim, konceptet kryesore të terapisë konjitive dhe të sjelljes, etj.

Trajnimi u mundësua nga dy trajnues shqiptarë që kishin përfituar më parë nga një aktivitet 'trajnim i trajnuesve' të organizuar nga UNODC/OBSH në Serbi. Kursi ishte një ndërthurje e mirë e teorisë me mjaft inskenime dhe ushtrime. Në fund, pjesëmarrësit u pajisën me certifikata. Trajnimi për Trajtimin Psikosocial është pjesë e Projektit të Përbashkët të UNODC/OBSH për Trajtimin dhe Kujdesin ndaj Drogës.



Foto: Trajnimi i dytë *Treatnet* i UNODC-ut për profesionistët në Shqipëri

Vizitë studimore në Indonezi e përfaqësuesve të qeverisë dhe OJF-ve: Buxhetimi Gjikor dhe Scorecards Bazuar në Komunitet

Në datat 17-22 korrik 2011, nën kujdesin e programit UN Women/Albania, përfaqësues të qeverisë, OJF-ve dhe PNUD/Shqipëri, morën pjesë në një vizitë studimore në Xhakartë dhe Jogiakarta të Indonezisë. Përfaqësuesit e qeverisë ishin nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabara, ndërsa OJF-të ishin nga Tirana, Elbasani, Shkoder dhe Kukësi. Qëllimi kryesor i vizitës studimore ishte shkëmbimi i përvojave vendore dhe kombëtare për Buxhetimin Gjikor. Rëndësi e veçantë iu kushtua lidhjes ndërmjet monitorimit të buxhetimit

dhe politikave nga këndvështrimi gjikor me *Scorecards* bazuar në Komunitet dhe rolin të aktorëve të ndryshëm në këtë proces.

Pjesa e parë e vizitës studimore u përqendrua në zgjerimin e njohurive për integrimin e çështjeve gjimore në politikat dhe buxhetin e Indonezisë. Pjesëmarrësit diskutuan për nismat e planifikimit të politikave dhe buxhetimit në nivel kombëtar dhe vendor, duke theksuar rolin dhe rëndësinë e buxhetimit pjesëmarrës, si një koncept që u mundëson qytetarëve të thonë fjalën e tyre gjatë akordimit të burimeve financiare publike. Në pjesën e dytë, pjesëmarrësit u familjarizuan me shembuj dhe përvoja konkrete të OJF-ve vendase në Xhakartë dhe Jogiakarta, se si kishin evokuar dhe ndikuar në akordi-

min e buxhetit nga ana e pushtetit vendor dhe kombëtar. Gjithashtu, u trajtua përdorimi i CSC-së dhe hapat e marrë për rregullimin ligjor të buxhetimit.

Pasi të kthehen në Shqipëri, OJF-të pjesëmarrëse pritet të vënë në jetë njohuritë e fituara gjatë vizitës studimore, si dhe të propozojnë projekte konkrete relevante për komunitetet e tyre. Gjithashtu, këto OJF do të ndajnë njohuritë e fituara me OJF të tjera, me qëllim që të bëhet i mundur zbatimi i proceseve të buxhetimit gjikor dhe CSC-së. Për përfaqësuesit e qeverisë, vizita do t'u shërbejë kur të ndërmarrin nisma në nivel vendor apo kombëtar që objektivat e barazisë gjimore të përfshihen në proceset e planifikimit dhe buxhetimit në Shqipëri.

Vizita studimore u organizua në



PFoto: Vizita studimore në Indonezi e përfaqësuesve të qeverisë dhe OJF-ve: Buxhetimi Gjinor dhe Scorecards Bazuar në Komunitet

kuadrin e Programit të përbashkët Një OJKB për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, financuar nga Fondi i Kohencës i Një OKB dhe nga Fondet Bazë të UN Women.

Menaxhimi i mbetjeve urbane, Gjermania 2 milion euro për Shqipërinë juglindore



Foto: Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Sokol Olldashi dhe Ambasadorja e Gjermanisë në Shqipëri, Karola Myller-Holtkemper firmosin marrëveshjen 'Menaxhimi i mbetjeve urbane në Shqipërinë Juglindore'

Përmirësimi i cilësisë së mjedisit, shëndetit publik dhe mbrojtja e burimeve natyrore në qarkun e Korçës ishte synimi i marrëveshjes 'Menaxhimi i mbetjeve urbane në Shqipërinë Juglindore', e nënshkruar sot nga ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Sokol Olldashi dhe ambasadorja e Gjermanisë në Shqipëri, Karola Myller-Holtkemper. Qeveria gjermane i ka akorduar Shqipërisë një grant prej 2 milion Euro, dhe kjo vetëm për fazën e

parë të këtij projekti, e cila do të shërbejë për mbulimin e periudhës së ndërmjetme deri në realizimin e landfillit për qarkun e Korçës, i cili do të jetë gati në vitin 2013. Ministri Olldashi sqaroi se faza e parë e këtij projekti parashikon punime për mirëmbajtjen e fushës ekzistuese, përmirësimin e depozitimit të mbetjeve, mbajtjen nën kontroll të situatës së shëndetit publik të banorëve të Shqipërisë Juglindore, konkretisht te qytetit të Korçës, Pogradecit dhe fshatrave përreth. 'Ky është një projekt i ndërmjetëm që do t'i paraprijë ndërtimit të landfillit me një paketë të siguruar financimi prej 9.8 milion Euro', - theksoi ministri Olldashi. Ambasadorja gjermane Karola Myller-Holtkemper u shpreh se projekti do të ketë një ndikim shumë të rëndësishëm jo vetëm për sa i përket mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve shqiptarë, por edhe në drejtim të turizmit. 'Sensibilizimi i qytetarëve për hedhjen e mbeturinave është një tjetër element shumë i rëndësishëm i këtij projekti, ku sigurisht përfitues të drejtëpërdrejt janë qytetarët e Korçës, Pogradecit dhe komunave përreth', - tha ambasadorja gjermane.

Ministria e Punës, strategji për punësimin e 65 mijë të rinjve

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka prezantuar strategjinë e re, vënia në zbatim e së cilës do të mundësojë punësimin e 65 mijë të

rinjve në vend. Gjatë prezantimit të strategjisë 3-vjecare, e cila do të bëhet nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Kombet e Bashkuara, zv/ministri i Punës, Kastriot Sulka deklaroi se kjo strategji do të bëjë të mundur punësimin e të rinjve nga moshë 15 deri 19-vjeç. "Strategjia e re, e cila do të mbështesë punësimin e të rinjve nga moshë 15 deri në 19 vjeç, ka një kosto prej 17.550.000 dollarësh", - sqaroi Sulka. Sipas tij, plani për punësimin e të rinjve është pjesë e strategjisë kombëtare për punësimin dhe formimin profesional dhe kontribuon në përmbushjen e objektivave të strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim. Zv/ ministri nënvizoi se strategjia e punësimit për këtë grup-moshë do të mundësojë forcimin e administrimit të tregut të punës për të rinjtë, dhe mbështetjen e tyre. "Papunësia, nën-punësimi dhe puna në të zehtë janë kosto e rëndë për Shqipërinë, çka e bën akoma më të domosdoshëm këtë plan-strategji", - nënvizoi zv/ministri i Punës, Kastriot Sulka.

Programi Kërkimor në Shkencat Sociale, i financuar nga Zvicra, lançohet me Prezantime nga Faza Paraardhëse

Pesë studiuues vendas të shkencave sociale, të financuar nga programi zviceran, paraqitën projektet dhe gjetjet e tyre gjatë një konference të mbajtur nga Universiteti Europian i Tiranës dhe Zyra e Bashkë-

punimit Zviceran në Shqipëri (SCO-A), në kuadrin e programit për promovimin e kërkimeve të zbatuar nga Universiteti i Friborgut, Zvicër.

Më datë 8 Korrik 2011, Universiteti European i Tiranës së bashku me Zyrën e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri (SCO-A), mbajtën një konferencë për lançimin e fillimit të fazës së re të financimit të studimeve kërkimore rajonale. Në këtë aktivitet u paraqitën pesë prezantime të përzgjedhura nga lista e projekteve studimore të shkencave sociale të financuara nga qeveria zvicerane. Kjo ngjarje shënoi fundin e fazës paraardhëse të këtij programi të promovimit të kërkimeve rajonale dhe fillimin e fazës tjetër që nis më 19 shtator 2011.

Institucionet që kishin marrë fonde për kërkime përfshinin ofrues vendas të shërbimeve të biznesit, universitete, Institutin e Statistikave (INSTAT) dhe qendra të tjera kërkimore. Projektet studimore prekinin tema të zhvillimit social si migrimi i brendshëm, kuotat gjinorë në politikë dhe të drejtat mbi tokën bujqësore.

“Programi ynë synon të përdorë kërkimin për qëllime zhvillimi dhe gjithashtu synon të ndërtojë kapacitetet kërkimore në vendet e Ballkanit Perëndimor”, tha Anne Savary, zv. Drejtore e Bashkëpunimit Zviceran. “Unë shpreh besimin se projektet kërkimore, gjetjet e të cilave do t’i dëgjojmë sot, do të kontribuojnë me sukses për të arritur këto qëllime dhe do të ndikojnë në proceset e vendim-marrjes”, shtoi Zj. Savary..

Programi i Promovimit të Kërkimeve Rajonale i zbatuar nga Universiteti i Friborgut, që nga viti 2008 ka financuar projekte kërkimore në shkencat sociale nga studiues dhe institucione kërkimore. Ai synon të mbështesë studiuesit e rinj dhe të përdorë kërkimin për zhvillimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Faza e re do të fillojë në shtator 2011 dhe do të fusë bashkëpunimin rajonal midis vendeve si element kyç. Njësia Vendore e Koordinimit të Programit ndodhet tek Universiteti European i Tiranës.

I gjithë financimi jepet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e cila përfaqësohet në Shqipëri nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran.

Për informacion të detajuar mbi Programin për Promovimin e Kërkimeve Rajonale, lutemi kontaktoni me Elda Bagavikin, Zyrtare e Programit Kombëtar, Zyra e Bashkëpunimit Zviceran, Elda.bagaviki@sdc.net; 0682060482 ose Njësia Vendore të Koordinimit të Programit: besart.kadia@rpp-westernbalkans.net



Foto: Studiuesit vendas prezantojnë gjetjet e tyre gjatë konferencës në Universitetin European të Tiranës

Misionet në vend

BANKA BOTËRORE

Vlerësimi i Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjshmërisë Financiare (PEFA), Misioni për Mbledhjen e të Dhënave Kryesore, 18-29 korrik: Qëllimi kryesor i mis-

ionit ishte të takohej me specialistët dhe ekspertët e të gjitha agjencive që morën pjesë në trajnimin e PEFA-s dhe të mbledhin të dhënat dhe informacionin që do të mbështetë përgatitjen e raportit të PEFA-s.

dialoguqeveridonatorë

Nga data 1 korrik 2011, USAID mori Kryesimin e Sekretariatit Teknik të Donatorëve nga Banka Botërore

Të gjitha komentet lidhur me Dialogun Qeveri-Donatorë janë më se të mirpëritura!

Doni të kontribuoni?

Nëse dëshironi të kontribuoni, dërgoni tekstin tuaj në zyrën e Sekretarit Teknik të Donatorëve (nevila.como@aidharmonisation.org.al) ose në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (koordinimi@km.gov.al) deri më datë 5 të çdo muaji. Teksti duhet të jetë mundësisht rreth 100 fjalë.

Shpërndarja:

Çdo botim do t’ju dërgohet më datë 15 të çdo muaji.

Cilët janë donatorët në Shqipëri?

Për të zbuluar cilët janë donatorët që operojnë në Shqipëri, klikoni [këtu](#).

Për t’u çregjistruar:

Lutemi dërgoni e-mail tek Nevila Çomo (nevila.como@aidharmonisation.org.al)

OSCE Government-Donor Dialogue Newsletter is supported by the OSCE Presence in Albania

